

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM DHËNIE ME QIRA

1. Fillimi i procedurave për dhënie me qira për 10 (dhjetë) vite, me anë të konkurrimit publik për sipërfaqen në total 306.83 ha e ndarë në 5 lote, konkretisht LOTI II me sipërfaqe prej 54.18 ha, ngastrat nr.6/a dhe nr.7 në fshatin Mnele, “Per park fotovoltai (stacionet, objektet perkatese etj), sipas Udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.
2. Çmimi dysheme i fillimit të konkurrimit për ngastren nr. 6/a “Djerre” është 143.000 (njëqind e dyzet e tre mijë) lekë/ha në vit për sipërfaqe të llojit “Djerre” dhe për 10.99 ha është 1.571.570 (nje milion e pesëqind e shtatedhjetë e nje mije e pesëqind e shtatedhjetë)lekë në vit ndersa për ngastren nr.7 “Djerre” është 143.000 (njëqind e dyzet e tre mijë) lekë/ha në vit për sipërfaqe të llojit “Djerre” dhe për 43.19 ha është 6.176.170 (gjashtë milione e njëqind e shtatedhjetë e gjashtë mije e njëqind e shtatedhjetë)lekë në vit për sipërfaqe të llojit “Djerre”, dhe në total 7.747.740 (shtatë milione e shtatëqind e dyzet e shtatë mije e shtatëqind e dyzet) lekë në vit e përllëgaritur kjo sipas VKM-së nr. 559, datë 29.7.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, dhe sipas Raportit mbi Studimin Tekniko-Ekonomik, përgatitur nga specialistët e fushës.
3. Qëllimi i përdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm të sipërfaqes “Kullote”, “Per park fotovoltai (stacionet, objektet perkatese etj).
4. Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurrimit për subjektet pjesëmarrëse në konkurrim, sipas pikës 14 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”, do të jenë :

Nr .	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues (e shprehur në pikë)
1	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20
2	Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25
4	Nivelin e punësimit në veprimtari	5
5	Masën e qirasë për lek/ha/vit	35

5. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim, sipas pikës 10 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”, është:

- l) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- m) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- n) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë;
- o) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- p) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- q) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- r) nivelin e punësimit në veprimtari;
- s) lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar/vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis, (VNM)
- t) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- u) adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks.

6. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim, sipas pikës 11 të udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”, janë:

- d) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- e) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- f) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

7. Vendi i zhvillimit të konkurimit: (Adresa): Zyra e Prokurimeve Publike, Bashkia Vau Dejës.

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: me date 31.12.2025, ora 09:30.

9. Informacion mbi Dokumentet e Konkurrimit Publik:

Dokumentet e Konkurrimit Publik mund të tërhiqen pranë Autoritetit Qiradhënës

Dokumente me pagesë:

Po X Jo ☐

Nëse Po

Monedha leke Çmimi 1500

Dokumentet Standarde të Konkurrimit Publik përbëhen nga:

- Formulari i Njoftimit;
- Kërkesa për Pjesëmarrje;
- Formulari i Sigurimit të Ofertës;
- Formulari i Ofertës;
- Ftesa për Ofertë;
- Formulari i Njoftimit të Fituesit;
- Formulari i Publikimit të Njoftimit të Fituesit;